



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/ Nr. 7520  
Data: 08.09.2022

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT TË HAPUR BUXHETOR ME QYTETARËT E  
KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

Procesverbali nga Dëgjimi i dytë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025, të mbajtur me datën **19.08.2022**, duke filluar nga ora **18:00** në **Shtëpinë e Kulturës "Imri Curri"**, me gjithsej 23 pjesëmarrës, prej tyre 15 gra dhe 8 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, Nënkryetari i Komunës, **z.Sevdi Dernjani**, si dhe drejtorë të drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2023, si dhe parashikimi për vitet 2024-2025, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**
2. **Diskutimi**

**Mehmet Ballazhi thekson:** Prezentimin e këtij draft buxheti do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

**Lindita Ballazhi thekson:** Çka nënkuptojmë me termin buxhet? Unë Çdo herë e krahasoj me jetën personale të çdo individi në bazë të të hyrave që inkason, i cili bën një planifikim për kostot e tij të jetës, për veshmbathje, për ushqim dhe shpenzime të tjera. Ashtu edhe në rastin e Komunës, buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, bazuar në Ligjin



Nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave që bëhet së fundi deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur konsulta me asamblesë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2023 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,431,545€), granti specifik për arsim (993,487€), granti specifik për shëndetësi (364,561€) dhe të hyrat vetanake komunale (560,121€). Pra, buxheti total për vitin 2023 do të jetë 3,349,714€. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2023, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore. Më pas vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor dhe nuk po ju detajeve. Nëse keni ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

## 2. Diskutimi

**Mehmet Ballazhi:** Pas prezentimit nga drejtoresha e hap diskutimin e lirë për projekt propozimet tuaja.

**Hyrijete Isufi:** Pika 6 ku thotë ndërtimi i pendës në Sarasellë në fshatin Seçishtë dhe pika 14 për muret mborjtëse, diçka informatë më gjërësisht në ka mundësi.

**Mehmet Ballazhi:** Penda në Sarasellë është ajo si prrua që vjen prej Krevenikut në Seçishtë dhe është e rrezikshme dhe vendosen pendat. Kurse muret mbrojtëse janë ndryshe, ato kanë me qenë të vendosura përgjatë rrugëve nëpër fshatra ku ka rrezikshmëri, shembje dheu e të tilla.

**Muzafer Dibrani:** Çka konkretisht ka ky projekti ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës?

**Majlinda Kaloshi:** Idea e Këtij projekti është që urës së Seçishtës me ia bashkangjit një aneks për këmbësor, që ka një hapësirë të ndame, veç për vetura e veç për këmbësor, dhe paralelisht ka mu zgjeru edhe rruga për vetura, ku kemi apliku përmes Ambasadës së Japonisë dhe jemi në pritje të përgjigjes.

**Avni Bushi:** Unë e kam një propozim, tu e marr parasysh varrezat te meliqt, me u ndërtu një pjesë e shkallve, shkak i pjerrtësisë së vendit.



**Mehmet Ballazhi:** Ne e kemi paraparë një investim kapital ku përfshihet rregullimi i varrezave të qytetit te pika 17 i draft buxhetit dhe në kuadër të këtij projekti është përfshirë edhe rregullimi i shkallve.

**Resul Suma:** Këndi i lojrave këtu përballë komunës është shkatërru dhe është kriju një pamje e keqe dhe sa janë mundësitë financiare me e rregullu këtë hapësirë të lojërave. Dhe e dyta është rreth Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinfektimit që nuk është bërë kurrë në Han të Elezit. Kish qenë mirë që me planifiku DDD, nëse jo këtë vit, së paku për vitin tjetër.

**Lindita Ballazhi:** Edhe këto propozime që nuk janë investime kapitale do t'i marrim parasysh, sepse ne nuk planifikojmë vetëm për investimet kapitale, por edhe mallra dhe shërbime.

**Ajnure Thaçi:** Unë kisha propozu që me u vendos kosha të mbeturinave në çdo lagje përgjatë rrugës, se po ka rrugë edhe nëpër lagje e fshatra që po s'po ka ku me i gjujt mbeturinat për rrugë ma t'gjata, disa edhe i kanë prish personat e pandërgjegjshëm, por do të ishte mirë me u vendos kosha nëpër çdo lagje.

**Hyrijete Isufi:** Sot kam parë që janë pastru me ujë me cisterna disa rrugë këtu në qytet, madje edhe qoshet e rrugëve e m'la përshtypje, deshta me dit a ka me vazhdu kjo që me u pastru rrugët?

**Mehmet Ballazhi:** Kur është koha shumë e nxehtë, i kemi nxjerrë për pastrim ose freskim të rrugëve me ujë. Kam bisedu edhe me menaxhmentin e fabrikës dhe ata na kanë premtu se do të na ndihmojnë në pastrimin e rrugëve, sidomos gjatë verës me i fresku apo me i la, jo veç rrugët kryesore në qendër, por edhe tjerat, megjithatë jemi vetëm në fazën e diskutimit, deri sa ta bëjmë një marrëveshje bashkëpunimi.

**Hyrijete Isufi:** Te pika 21, vendosja e ekranit për prezentimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në rr.Nuri Bushi, a merren rezultatet nga matësi?

**Mehmet Ballazhi:** Po, kjo te rr.Nuri Bushi do të jetë veç ekran apo ekspozues ku kanë mu shfaq rezultatet e ndotjes tu u bazu te matësi që gjendet te shkolla fillore.

**Resul Suma:** Tashmë nuk po dihet fati i banesave të vjetra në Han të Elezit, dhe nëse nuk parashihet prishja e tyre, a do të ishte e mundur ngjyrosja apo vendosja e mureleve nëpër muret e banesave?

**Mehmet Ballazhi:** Çështjen e banesave e kam diskutu edhe ndryshe, ku e kemi paraqit edhe në KPF dhe s'ka kalu, edhe pse kemi bo të gjitha projektet dhe kemi paraqit shumë fakte për rrezikun që na kanoset nga to. Dhe mendoj se ma mirë me u duk ashtu të këqija, mos të mbulohen me fasadë, sepse njerëzit edhe mashtrohen nga ajo fasada edhe harrohet se sa rrezik paraqesin.

**Anisa Ballazhi:** Ne sot këtu jemi prezent edhe nxënësve e studente dhe edhe pse po flas unë, por po e shpreh pyetjen që e kanë një i madh i nxënësve, është çështja e transportit për Ferizaj apo Prishtinë, ku nuk ka një stacion autobusash, por edhe orare jo gjithmonë të përshtatshme. Edhe pse disa herë e kemi diskutu, por mirë me e sqaru si qëndron puna edhe mos me pyet mo



nxënësit e studentat vazhdimisht për qet punë, shkak se shumë nxënës ose studentë në Ferizaj, detyrohen me ju kërku profesorave me dal para kohe nga mësimi ose me qëndru te familjarët, ose me dal dikush prej familjes me i marr. Cila kishte me qenë zgjidhja për këto raste, që me ju ndihmu nxënësve dhe studentave?

**Mehmet Ballazhi:** Për stacion e kemi të pamundur, kjo më shumë i takon Ministrisë, por ajo që mundemi me bo është me këto ndalesat me bo diçka, me i rregullu, që kur bje shi me pas ku me prit.


**Ajnure Thaçi:** Çka parashihet me u bo te kjo pika për ndërtimin e aneks objektit dhe infrastrukturës në QKMF?

**Kimete Kuka-Hasallari:** Po mendojmë me e shtu një pjesë të hapësirës, sepse ka aparatura e donacione të ndryshme që vijnë dhe po zihen hapësirat, si dhe mendohet me u rregullu energjia elektrike.

**Mehmet Ballazhi:** A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin e hapur buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 18:36.

Procesmbajtësja  
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi